

183

110/1



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT
KRYETARI

Nr. 1058/Prot.
11

Tiranë, më 4.8.2021

Lënda: Kthim përgjigje

Z. DORIAN MATLIJA
Drejtör Ekzekutiv
QËNDRA "RES PUBLICA"
Adresa: Bulevardi "Gjergj Fishta", Nd. 24, H. 3, Ap. 7, Tiranë

I nderuar z. Matlija,

Në përgjigje të shkresës suaj, nr. 110/21 prot., me objekt: "Kërkesë për informacion dhe vënie në dispozicion dokumentacioni", protokolluar në Kolegjin e Posaçëm të Apelit, me nr. 1058 prot., datë 29.07.2021, parashtrojmë si më poshtë vijon.

1. Në përgjigje të pyetjes së parë, mbi numrin e këshilltarëve ligjor dhe ekonomik të parashikuar dhe sa ishin caktuar në fillim të procesit të vetingut, e në vazhdim për periudhën (2018-2021), ju bëjmë me dije se, me vendimin e Kuvendit të Shqipërisë nr. 92/2017 "Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit", janë përcaktuar 7 (shtatë) këshilltarë ligjorë dhe 3 (tre) këshilltarë ekonomik. Në zbatim të këtij vendimi janë emëruar në detyrë 7 (shtatë) këshilltarë ligjorë më datë 15.01.2018 dhe 3 (tre) këshilltarë ekonomik më datë 01.02.2018.

Me vendimin e Kuvendit të Shqipërisë nr. 101/2018 "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin e Kuvendit nr. 92/2017 "Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit", është përcaktuar shtesa me 4 (katër) këshilltarë ekonomik. Në zbatim të këtij vendimi janë emëruar në detyrë 4 (katër) këshilltarë ekonomik, përkatësisht në datat 04.01.2019, 10.01.2019, 11.01.2019 dhe 21.01.2019.

Me vendimin e Kuvendit të Shqipërisë nr. 82/2020 "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin e Kuvendit nr. 92/2017 "Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit", është përcaktuar shtesa me 4 (katër) këshilltarë ligjorë dhe 2 (dy) këshilltarë ekonomik. Në zbatim të këtij vendimi janë emëruar në detyrë 2 (dy) këshilltarë ligjorë në datat 18.06.2021 dhe 01.07.2021, si edhe 1 (një) këshilltar ekonomik më datë 12.07.2021. Ndërkohë që, aktualisht janë në procedura rekrutimi pozicionet për 2 (dy) këshilltarë ligjorë dhe 1 (një) këshilltar ekonomik. Aktualisht, sipas strukturës së miratuar me këtë vendim, Njësia e Shërbimit Ligjor është e përbërë nga 11 (njëmbëdhjetë) këshilltarë ligjorë dhe 9 (nëntë) këshilltarë ekonomik.

2. Në përgjigje të pyetjes së dytë, mbi numrin e këshilltarëve ligjorë që kanë dhënë dorëheqjen apo janë shkarkuar dhe sa këshilltarë ligjor të rinj janë emëruar për ti zëvendësuar për periudhën (2018-2021), ju informojmë se, në tetor të vitit 2019 ka dhënë dorëheqjen 1 (një) këshilltar ligjor, i cili është zëvendësuar në janar të vitit 2020. Sa i takon, numrit të këshilltarëve ligjor të shkarkuar, rezulton 1 (një) këshilltar ligjor i shkarkuar në dhjetor të vitin 2018, pozicion i cili është zëvendësuar në mars të vitit 2019. Për vitin 2021 ka dhënë dorëheqjen 1 (një) këshilltar ligjor, i cili ndërpret marrëdhënien e punës me Kolegjin e Posaçëm të Apelimit më datë 31.08.2021.

3. Në përgjigje të pyetjes së tretë, mbi numrin e këshilltarëve ekonomik që kanë dhënë dorëheqjen apo janë shkarkuar dhe sa këshilltarë ligjor të rinj janë emëruar për ti zëvendësuar për periudhën (2018-2021), ju informojmë se, nga viti 2018 deri aktualisht në vitin 2021 nuk ka asnjë rast dorëheqje apo shkarkim të këshilltarëve ekonomik.

4. Në përgjigje të pyetjes së katërt, mbi arsyet e dorëheqjes/ shkarkimit të tyre, ju informojmë se 1 (një) këshilltar ligjor ka kërkuar dorëheqjen për arsye personale ndersa 1 (një) këshilltar ligjor është dorëhequr për shkak të emërimit në institucion tjetër. Sa i takon rastit të 1 (një) këshilltari ligjor të shkarkuar, arsyeja e shkarkimit është marrja e masës disiplinore "shkelje shumë e rëndë", në formën e mospërbushjes së rëndë të detyrave dhe zgjidhjen e menjëhershme të kontratës së punës.

Duke ju falënderuar,

KRYETARI

Albana Shtylla

